



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Bekim Jashari, Kryetar i Komunës së Skenderajt Fatbardha Haliti, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 15.01.2020 Nr.0-9
Zyrtaret përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Vjosa Ahmetaj, Zyrtare për monitorim të komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Skenderajt	
Lloji i aktit:	<input type="checkbox"/> Rregullore e Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Rregullore e Kuvendit të Komunës Nr. 01-110/01-0073215/19 për menaxhimin e parkingjeve publike në Komunën e Skenderajt
I miratuar më datë: 27.12.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.01.2020

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Bekim Jashari, gradonačelnik Opštine Srbica Fatbardha Haliti, predsedavajuća Skupštine opštine Srbica	
Cc:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini	
Preko:	Adrijana Hodžić, ministarka administracije lokalne samouprave Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i nadgledanje opština, MALS	Dana, 15.01.2020. Br.0-9
Odgovorni službenici:		
1. Potvrđeno od:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za nadgledanje opština	
2. Izrađeno od:	Vjosa Ahmetaj, službenica za nadgledanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta Opštine Srbica	
Vrsta akta:	<input type="checkbox"/> Uredba Skupštine opštine	

Uvaženi gradonačelnice,
Uvažena predsedavajuća,


U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, Pravnom odeljenju i nadgledanje opština Ministarstva za administraciju lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Uredba Skupštine opštine br. 01-110/01-0073215/19 za upravljanje sa javnim parkinzima u opštini Srbica
Usvojena dana: 27.12.2019.
Dotsavljena MALS-u za razmatranje dana: 03.01.2020.


Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt sa proceduralnog aspekta u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvoditi pravni efekat. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj



Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Pas shqyrtimit të propozim-vendimit të Kryetarit të Komisionit për Statut dhe Rregullore të Komunës së Skenderajt me nr.01-110/01-0073215/19, të dt.10.12.2019, në mbështetje të nenit 12 par 1, 2 shkronja c), dhe nenit 40 par. 1, 2 shkronja a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, qershor 2008, neni 4, 11, 14 par. 1.7 dhe neni 15 të Rregullores (MAPL) nr. 01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit e Akteve të Komunës dhe neni 14 par. 1, 2 shkronja c), neni 17 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr. 01-110-385, i dt.03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 27.12.2019 miratoi këtë:

V E N D I M
PËR RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E PARKINGJEVE PUBLIKE NË KOMUNËS E
SKENDERAJT

I

Miratohet propozim-vendimi, nr.01-110/01-0073215/19, të dt.10.12.2019 për Rregullore për Menaxhimin e Parkingjeve Publike në Komunën e Skenderajt.

II

Kjo rregullore ka për qëllim të rregulloj mënyrën e menaxhimit dhe shfrytëzimit të rregullt dhe efikas të parkingjeve publike në komunën e Skenderajt.

III

Vendimi do të publikohet në tabelën e shpalljeve si dhe në ueb-faqe të Komunës së Skenderajt.

IV

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe publikimit të tij në ueb - faqen e Komunës.

Vendimi i Dërgohet :

- 1x1 Arkivit;
- 1x1 MAPL-së;
- 1x1 Zyrës së Kryetarit;
- 1x1 Tabelës së Shpalljeve Publike;
- 1x1 Komisionit për statut dhe rregullore;
- 1x1 Dosjes.




Kryesuesja e KK-së;
Znj. Fatbardha Haliti



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



№ 01.140/201-00.331/15/10
10.12.2019



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E PARKINGJEVE
PUBLIKE NË KOMUNËN E SKENDERAJIT**

Skenderaj, Dhjetor 2019

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) te nenit 14 pika 14.2 shkronja c) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, Kryetari i Komunës së Skenderajt i propozon Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e mbajtur me datën _____ 2019 të miratojë:

RRREGULLORE

PËR MENAXHIMIN E PARKINGJEVE PUBLIKE NË KOMUNËN E SKENDERAJIT

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë mënyrën e menaxhimit dhe shfrytëzimit të rregullt dhe efikas të parkingjeve publike në Komunën e Skenderajt.

Neni 2

Fushëveprimi

Menaxhimi e punëve për rregullimin, shfrytëzimin edhe mirëmbajtjen e parkingjeve e ushtron personi juridik apo fizik i cili përcaktohet nëpërmjet procedurave të zhvilluara nga Zyra e Prokurimit Publik të Komunës së Skenderajt, duke i respektuar kushtet dhe kriteret që i përcakton Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Neni 3

Përfundimet

1. Përfundimet në vijim në kuptim të kësaj rregulloreje kanë këtë domethënie:

1.1. D.Sh.P. - Drejtoria për Shërbime Publike.

1.2. Parkingjet publike – janë sipërfaqet e trafikut publik dhe sipërfaqet e veganta të caktuara dhe të shënuara për parkim të njëjeteve motorike.

1.3. Parkingjet e përbërshme – janë objektet e ndërtuara për parking, sipërfaqet e trafikut publik dhe sipërfaqet e posaqme të ndërtuara për parking.

1.4. Parkingjet e posaqme, për shfrytëzimin e të cilave paguhet çmimi i parkimit.

Neni 4

Destinimi i parkimeve publike

1. Parkimet publike, varesisht prej llojit të mjeteve motorike, mund të destinohen për parkim të:

- Mjeteve motorike për udhëtarë;
- Autobus deri 28 ulëse si dhe autobusë mbi 28 ulëse
- Vetura/autonjete deri 3.5 ton, vetura/autonjete mbi 3.5 ton
- Motoçiklet, triciklet etj;

Neni 5

Ndarja në zona e parkimeve publike

1. Parkimet e posaçme, sipas kohës së lejuar për parkim dhe lartësisë së çmimit, ndahen në zona:

- a). Zona e parë, në të cilat koha e parkimit kufizohet në 60 minuta;
- b). Zona e dytë, vende me shkalë të lartë të shfrytëzimit, në të cilat koha e parkimit nuk është e kufizuar;
- c). Zona e tretë, vende me shkalë të ulët të shfrytëzimit, në të cilin koha e parkimit nuk është e kufizuar.

Neni 6

Mënyra e kontrollimit të parkimeve publike

1. Në parkimet e posaçme mund të bëhet kontrollimi i hyrjeve – daljeve mund të bëhet kontrollimi të mjeteve motorike.

2. Kontrollimi nga paragrafi 1 i këtij neni mund të bëhet duke vendosur laura, ndërtimin apo vendosjen e objekteve për pagesë, apo në ndonjë mënyrë tjetër.

Neni 7

Caltoni i lokacioneve për parkingje publike

4

Parkingjet publike caktohen me Vendim të Kuvendit të Komunës, me propozim të Drejtorisë për Shërbime Publike.

Neni 8

Sinjalizimi i parkingjeve publike

1. Parkingjet publike duhet të jenë të sinjalizuara me sinjalizim përkatës horizontal dhe vertikal, në përputhje me rregullat për siguri në trafik.
2. Parkingjet e posaçme, përveç sinjalizimit për trafik, duhet të kenë të shënuar në vend të dhukshëm të dhënat si: zonën e parkimit, llojin e mjeteve motorike, gëminin e parkimit dhe kohëzgjatjen e parkimit.

Neni 9

Rregullimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i parkimeve publike

1. Personi juridik apo fizik, të cilit përmes procedurave të tenderimit iu ka besuar puna e shfrytëzimit të parkimeve publike, është i obliguar të rregullojë, mirëmbajë dhe të sinjalizojë parkingjet publike.
2. Mjetet financiare për kryerjen e punëve nga paragrafi 1 i këtij neni, në parkingjet e posaçme sigurohen nga të hyrat e inkasuar nga pagesa e parkimit.

Neni 10

Detyrat dhe përgjegjësitë e shfrytëzuesve të parkimeve

1. Shfrytëzues të parkimeve publike janë ngasefit, gëjegjësit pronarët e mjeteve motorike.
2. Shfrytëzuesit janë të obliguar të shfrytëzojnë parkingjet në përputhje me sinjalizimin e trafikut dhe shënjave të përcaktuara në nenin 11 paragrafi 2 i kësaj rregulloreje.

Neni 11

Vend – parkimet për personat me nevoja të veçanta

Vend - parkimet për personat me nevoja të veçanta , duhet të jenë të signalizuara dhe të njëjtat mund ti shfrytëzojnë vetëm personat të cilit posedojnë dokumentacion, me të cilin dëshmohet se personi ka nevoja të veçanta.

Neni 12

Lloji i mjeteve që lejohet parkohen në parkimet publike

1. Parkimet publike të destinuara vetëm për një lloj të mjeteve motorike, mund të shfrytëzohen vetëm për atë lloj të mjeteve motorike.
2. Në parkimet publike për mjete transportues dhe autobus duhet të ndërtohet nija sanitare.2

Neni 13

Rezervimi i vend parkimeve për raste të veçanta

1. Drejtoria për Shërbime Publike në raste të veçanta mund të lejojë rezervimin e vend – parkimit në parkimet publike për nevoja të organeve shqetësojë apo përfaqësuesve tjerë të huaj, shërbimeve publike, ndërmarrjeve publike si: „UNITETI”, „INSPEKSIONI, „KEDS” , „PTK” , „POLICIA E KOSOVËS” , „FSK” , „SHERBIMI I ZJARRËFKËVE” , si dhe transportuesit e rregullt të udhëtarëve të cilit janë të obliguar të pajisen me licencë duke përfshirë: taksi individual, radio – taksi, dhe autobusët.
2. Në këto vend – parkime të rezervuara në parkimet e veçanta, gjatë kohës së rezervimit të vend – parkimit nuk zbatohen dispozitat e nenit 8 paragrafi 1 për kufizimin kohor të shfrytëzimit të parkimit të posaçëm.
3. Drejtoria për Shërbime Publike përveç rasteve të vendim të veçantë kushtet për rezervimin e vend parkimit nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 14

Mënyra e pagesës së çmimit për parkim

1. Për shfrytëzimin e parkimut të posaçëm, shfrytëzuesi është i obliguar të paguaj gminin e parkimit, varësisht nga koha e shfrytëzimit të vend parkimit dhe zonës në të cilën gjendet vend parkimi.

2. Vlera e pagesës së parkimit sipas paragrafi 1 të këtij neni dhe vlera e provizionit për Komunë, përcaktohet në bazë të procedurave të tenderimit.

3. Kjo vlerë e pagesës nuk mund ta tejkalojë shumën maksimale të përcaktuar në Rregulloren Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.

4. Çmimet përcaktohen me nxjerrjen e një vendimi nga drejtoria përkatëse.

Neni 15

Obligimet e shfrytëzimit

1. Shfrytëzuesi është i obliguar të paguaj gminin e parkimit nga neni 17. Paragrafi i kësaj rregulloreje për çdo orë të filluar të shfrytëzimit.

2. Shfrytëzuesi është i obliguar të respektojë kohën e lejuar për parkim.

Neni 16

Obligimet e personave me nevoja të veçanta

1. Shfrytëzimin e vend parkimeve të caktuara për persona me nevoja të veçanta në parkimet e posaçme, nuk e paguajnë shfrytëzuesit të cilët në autonjet kanë të ekspozuar në vend të dukshëm tiketën ngjiltese, gjegjësisht shenjtën përkatëse të personit me nevoja të veçanta.

2. Nuk paguhet gmini i parkimit gjatë kohës së aksioneve intervenoj për : autonjetelet e ndalimës së parë, Policisë, Forcës së Sigurisë së Kosovës, Njësisë së Zjarritkësve dhe Inspekcionit, Keds, Unitetit dhe Pk.

Neni 17

Shfrytëzimi i parkimjeve nga subjektet e tjerë

Subjektet e tjera siç janë: banorët, shfrytëzuesit e lokaleve afariste etj. Mund të shfrytëzojnë parkimjelet në bazë të një marrëveshja me operatorin që menaxhon parkimjelet publike, në harmoni me kushtet dhe mënyrën që e përcakton D.Sh.P - ja, sipas rregullores Nr. 01-110/04-0000142/17 për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa Komunale.

Neni 18

Shfrytëzimi i parkimjeve të përgjithshme

1. Në parkingt e përgjithshme, për shfrytëzimin e të cilave nuk paguhet çmimi i parkimit (parkingt e kolegjeshskolshme) sipas neni 6 paragrafi 1 pika 1.1 të kësaj rregulloreje, komuna apo operatori ekonomik i përzgjedhur, nuk mban përgjegjësi për dëmtime apo vjedhje të automjeteve apo të gjërave brenda automjeteve në parkinge publike.

7

2. Në parkingt publike, të cilat në kanë besuar punët e rregullimit, mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit, personave juridik apo fizik, sipas neni 12 të kësaj rregulloreje shfrytëzuesi i parkingut duhet të përkuqdeset për mos dëmtimin apo mos vjedhjen e mjeteve motorike.

Neni 19

Kontrolli i shfrytëzimit të parkingjeve publike

1. Kontrollin e pagesës dhe shfrytëzimit të parkingjeve të posaçme e bëjnë personat e autorizuar nga menaxheri (Komuna).
2. Personat e autorizuar duhet të posedojë kartë identiteti dhe janë të obliguar të barin uniformën.
3. Menaxheri përcakton dukjen dhe përmbajtjen e kartelës së identitetit të personave të autorizuar, si dhe dukjen e uniformes nga paragrafi 2 i këtij neni.

Neni 20

Shfrytëzimi jo i duhur i parkingjeve publike

1. Shfrytëzuesi i cili shfrytëzon parkingun e posaçëm në kundërshtim me nenin 18 të kësaj rregulloreje, është i obliguar të paguaj çmimin e posaçëm të parkimit, sipas çmimit të përcaktuar nga menaxheri (Komuna).
2. Urdhëresën për pagesën e çmimit të posaçëm e lëshon personi i autorizuar dhe ia dorëzon pronarit të mjeteve motorike.
3. Kur personi i autorizuar nuk ka mundësi që ta dorëzoj urdhrë-pagesën, të njëjtin e vendos në mjete motorik.
4. Dorëzimi i urdhrëpagesës në mënyrën e përshkruar nga paragrafi 3 të këtij neni, konsiderohet i rregullt dhe dëmtimi ose asgjësimi i mjëvonshtëm i urdhrë- pagesës nuk ka ndikim në vlefshmëritë e dorëzimit dhe nuk e shpynë afatin e pagesës.
5. Shfrytëzuesi është i obliguar që në afat prej (8) ditësh, të bëjë pagesën në mënyrën e përshkruar në urdhrëpagesë.

Neni 21**Ndalozat**

1. Ndalohet parkimi i mjeteve motorike në kundërshtim me signalizimin e trafikut sipas neni 13 paragrafi 2 i kësaj rregulloreje, si dhe çfarëdo pagese për shfrytëzimin e tille të parkimeve publike.
2. Ndalohet parkimi i mjeteve motorike të paregjisuara apo pa tabela të regjistrimit.
3. Ndalohet parkimi i mjeteve motorike në vend parkim të rezervuar për parkim të automjeteve për persona me nevoja të veçanta, nëse nuk kanë tike të ngjitëse sipas neni 13 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.
4. Ndalohet parkimi i mjeteve motorike të dentuara, parkimi i rimorkiove pa mjedin tërheqës, përdorim i parkingut në kundërshtim me destinimin, rrethimi i vend – parkimi, rregullimi i vend – parkimi të rezervuar me vetë dëshirë, larja e automjeteve , vendosja e shitësve ambulanti, dhe aktiviteve tjera që sjellin papastërti dhe dëmtim të parkingut publik.

Neni 22**Mblikëqyrja**

1. Mblikëqyrja e zbatimit të kësaj rregulloreje e bënë D.Sh.P. – dhe Drejtoria për Inspektim.
2. Punët në mblikëqyrjen inspektuese në zbatimin e kësaj rregulloreje akteve të tjera nëpërmjet Inspektori të Trafikut, dhe të Shërbimeve Publike.

Neni 23**Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Inspektim në fushën e parkimeve publike**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Inspektim në fushën e parkimeve publike janë:
 - 1.1. Të kontrollojë signalizimin e trafikut në parkingjet publike dhe ti urdhëroj menaxherit për të mënjanuar mangësitë eventuale në afat të caktuar;
 - 1.2. Të kontrollojë gjendjen teknike të parkingut publik dhe të urdhëroj menaxherin për të mënjanuar mangësitë eventuale në afat të caktuar;

1.3. Të kontrolluajtë pajisjet e parkimeve publike në harmoni me aktet normative të Komunes dhe të urdhërve menaxherin për të mënjtuar mangësitë eventuale, në afat të caktuar.

1.4. Të urdhërojtë ndërrimin e regjimit të trafikut gjegjësisht parkimit në parkingjet publike me qëllim të rritjes së sigurisë në trafik, duke u bazuar në rekomandimet profesionale.

9

Neni 24

Autorizimet tjera të Inspektorit

1. Inspektori është i autorizuar të urdhërojtë shfrytëzuesit (menaxherin) e parkingut largimin o menjëhershëm të njëjtit motorik i cili është i parkuar në kundërshtim në këtë rregullore , duke urdhëruar largim të dhunshëm te njëjti motorik (meninangë).

2. Në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni nëse shfrytëzuesi nuk ndodhet në vend ngjarje ose kundërshton largimin e automjetit inspektori obligon menaxherin ta identifikoj automjetin përmes Policisë dhe te merren masa me të cilat urdhërohet largimi i automjetit në afat të caktuar.

3. Inspektori obligon menaxherin për largimin e automjetit duke përdorur automjetin special (meninangë) në rast se shfrytëzuesi nuk vepron në harmoni me urdhrin sipas paragrafi 1 te këtij neni, gjegjësisht sipas paragrafi 2 te këtij neni.

4. Inspektori është i autorizuar të kontrolloj nëse parkingjet publike përdoren në harmoni me deshimin e dëftuar në këtë rregullore, dhe të urdhërojtë mënjanimin e mangësive në afat të caktuar.

5. Inspektori është i autorizuar (të bëj kërkese) për kallxin kundërvajtje në rast të mosveprimit sipas vendimit ekzekutiv si dhe në harmoni me këtë rregullore dhe aktet tjera te nxjerrura në bazë të kësaj rregulloreje.

Neni 25

Dispozitat ndëshkuese- Global

1. Me gjohë prej pesëqind 500,00 € deri në njënjtë 1000,00 € do të ndëshkohet menaxheri për këto kundërvajtje:

1.1. Nëse nuk vepron në përputhje me nenin 10 të kësaj rregulloreje;

1.2. Nëse nuk vepron në përputhje me nenin 11 të kësaj rregulloreje;

1.3. Nëse nuk e pajisë parkimun publik në përputhje me nenin 14 të kësaj rregulloreje.

2. Me gjohë prej 500,00 € deri 1000,00 € do të ndëshkohet përfaqësuesi, personi juridik nëse:

2.1. Përdor parkimjet publike në kundërshtim me nenin 19 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje;

2.2. Vepron në kundërshtim me nenin 23 të kësaj rregulloreje.

Neni 26

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohen : Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Inspektimë , Drejtori i çera Kompetente Komunale dhe Policia e Kosovës.

Neni 27

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi (15) ditë pas regjistritimit në Zyrtën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Skenderajt.

Nr. _____ Kuvendi Komunal -Skenderaj
Skenderajt, me _____ 2019 Kryesuesja e kuvendit
Fatbardha Haliti

Vjosa Ahmetaj

From: Bahrije Berisha
Sent: 17 January 2020 10:05
To: Rozafa Ukimeraj; Xhevat Tafa; Aurora Kadriu; Venera Çerkini; Vjosa Ahmetaj
Cc: Naim Baftiu; Enis Spahiu; Lumnije Hetemi; Jeton M. Gashi; Florije A. Gashi; Antoneta Shtufi; Bashkim H. Isufi; Razije Murtezaj
Subject: Rregullore për menaxhimin e parkingjeve Skenderaj
Attachments: 26 MAPL- Rreg. nr.01-110-1-0073215-19 per menaxhimine parkingjeve K.Ske....pdf

Të nderuar/a,

Këtë akt të Komunës së Skenderajt e rikthejmë, sepse nuk e prek Ministrin e Financave por prek ministrit e tjera të linjës, sektorin hapësinor, gjobat, policin etj, .

Ministria e Financave në vazhdimësi po pranon akte të komunave të cilat nuk e prekin fushën e Ministrisë së Financave, ju lutem para se ti dërgoni këto akte tek ministrit e linjës i verifikoni se cilës ministri i takon.

Me respekt,

Bahrije Berisha

Vjosa Ahmetaj

From: Muje Selmani
Sent: 15 January 2020 10:04
To: Vjosa Ahmetaj
Subject: RE: Njoftim.....

Konfirmoj

Me respekt:

Jui.dip.Mujë Selmani

Zyrtarë i lartë Profesional për punët e kuvendit.

Komuna Skenderaj.

Centrex: 038 42 720

Mob: 044/399-032, 049/238-183

e-mail: Muje.Selmani@rks-gov.net

muje.selmani@hotmail.com

From: Vjosa Ahmetaj
Sent: Wednesday, January 15, 2020 9:55 AM
To: Fatbardha Haliti
Cc: Xhevat Tafa; Muje Selmani
Subject: Njoftim.....

E nderuar,

Ju njoftoj lidhur me Rregulloren Nr. 01-110/01-0073215/19 për menaxhimin e parkingjeve publike në Komunën e Skenderajt, do të dërgohet për vlerësim të ligjshmërisë në Ministri të Financave, ju lutem të mos behët publikimi i këtij vendimi deri sa të pranoni raportin e vlerësimit të ligjshmërisë.

Me respekt,
Vjosa Ahmetaj

Aurora Kadriu

From: Bahrije Berisha
Sent: 17 January 2020 10:05
To: Rozafa Ukimeraj; Xhevat Tafa; Aurora Kadriu; Venera Çerkini; Vjosa Ahmetaj
Cc: Naim Baftiu; Enis Spahiu; Lumnije Hetemi; Jeton M. Gashi; Florije A. Gashi; Antoneta Shtufi; Bashkim H. Isufi; Razije Murtezaj
Subject: Rregullore për menaxhimin e parkingjeve Skenderaj
Attachments: 26 MAPL- Rreg. nr.01-110-1-0073215-19 per menaxhimine parkingjeve K.Ske....pdf

Të nderuar/a,

Këtë akt të Komunës së Skenderajt e rikthejmë, sepse nuk e prek Ministrin e Financave por prek ministrin e tjera të linjës, sektorin hapësinor, gjobat, policinjetj, .

Ministria e Financave në vazhdimësi po pranon akte të komunave të cilat nuk e prekin fushën e Ministrisë së Financave, ju lutem para se ti dërgoni këto akte tek ministrin e linjës i verifikoni se cilës ministri i takon.

Me respekt,

Bahrije Berisha